

LUDMILA BUXHELI

### JORGJI GJINARI PËR METODOLOGJINË E STUDIMIT TË DALLIMEVE DIALEKTORE NË FUSHËN E MORFOLOGJISË\*

Të vlerësosh studiuesin Jorgji Gjinari si gjuhëtar nuk është e lehtë, sepse veprimtaria e tij kërkimore-shkencore e botuese është e pasur, e larmishme për nga tematika e problematika që trajton dhe, mbi të gjitha, me mjaft kontribute. Nën drejtimin e tij u hodhën bazat e dialektologjisë shqiptare si shkencë, një veprimtari shkencore e organizuar, që nisi me krijimin e sektorit të dialektologjisë, me krijimin e kartotekës dhe të fonotekës dialektore, e duke vijuar më tej, nën drejtimin e tij, me hartimin e skicave e monografive për të folmet e shqipes, për dukuri dialektore fillimisht të pjesshme e të shkëputura nga sfera të ndryshme të gjuhës e më pas për veçoritë e të folmeve për të gjitha sferat e gjuhës. Po ashtu nën drejtimin e Gjinarit u bënë edhe studime përgjithësuese për dukuri të veçanta dialektore ose për grupe të folmesh e për të gjitha të folmet të marra së bashku. Përveçse një organizator i talentuar si drejtues i departamentit të dialektologjisë, Gjinari është autor i një vargu monografish për të folme të ndryshme të shqipes, autor i veprës *Dialektet e gjuhës shqipe* (Tiranë, 1989), e cila është vepra më e plotë e përgjithësuese mbi dialektologjinë e gjuhës së sotme shqipe. Po ashtu, ai është bashkautor dhe drejtues i veprës madhore *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (Napoli, 2007). Nuk mungojnë kontributet e tij edhe në fusha të tjera të albanologjisë, si dialektologji historike, prejardhja e gjuhës shqipe, gjuhë letrare etj.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e J. Gjinarit spikat gjithashtu për metodologjinë e ndjekur në studimet e tij. Dihet që përcaktimi i metodologjisë së punës kërkimore shkencore nuk është një punë e lehtë, sepse përveç objektit dhe qëllimit të studimit, kërkohet gjithashtu përcaktimi i bazës teorike dhe i kriterëve të mbledhjes së bazës së të dhënave gjuhësore të nevojshme për një studim. Parë në këtë këndvështrim, vështirësitë me të cilat është ndeshur J. Gjinari për përcaktimin e metodologjisë së punës së tij kërkimore shkencore ishin të mëdha, por ato rëndoheshin më shumë, sepse veprimtaria e tij zhvillohet kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit '20, në kushtet e një regjimi të egër e totalitar, që, për shkaqe ideologjike, pengonte lirinë akademike në fushën kërkimore-shkencore, gjë që nuk mundësonte njohjen e plotë të arritjeve bashkëkohore në fushën e studimeve dialektore. Megjithatë,

---

\* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore për nder të 80-vjetorit të lindjes së gjuhëtarit Jorgji Gjinari, 18 dhjetor 2015.

me gjithë vështirësitë, studimet e Gjinarit mbështeten në njohjen dhe zbatimin koherent të arritjeve bashkëkohore në fushën e studimeve dialektore, në një lëndë të pasur dialektore, të siguruar nëpërmjet hetimeve dhe vëzhgimeve të hollësishme të lëndës gjuhësore të grumbulluar në terren. Tipar karakteristik janë gjithashtu përpjekjet për analiza të hollësishme dhe me argumentime bindëse të dukurive dialektore, të lidhjeve të tyre me historinë e gjuhës shqipe, shoqëruar dhe me përgjithësimet teorike. Gjinari e shikon gjuhën si një strukturë, pjesë e së cilës janë fonetika, fonologjia (fonemat), morfologjia e sintaksa, ndërsa njësitë gjuhësore si struktura me një funksion gjuhësor të caktuar. Autori jep të dhëna me interes sidomos për sistemin fonemor të shqipes, zanoret, bashkëtingëlloret, diftongjet, grupet e bashkëtingëlloreve, por edhe për sistemin morfologjik e leksikor.

Kontributin e J. Gjinarit për nevojën e përsosjes së metodologjisë së punës kërkimore-shkencore në fushën e studimeve dialektore të shqipes e shohim në sprovën e tij për klasifikimin strukturor të dallimeve morfologjike të dialekteve të gjuhës shqipe. Kemi të bëjmë me një çështje metodologjike dhe analize të ndryshme nga ajo e fazës së parë të studimeve dialektore në fushë të shqipes. Gjinari pohon se në fazën e parë, deri në fillimet e viteve '50 të shekullit XX, studimet dialektore në fushë të shqipes ishin kryer kryesisht nga të huajt, ato ishin të paorganizuar, të rastit dhe nuk mbulonin gjithë dialektet e të folmet e shqipes. Ndryshe nga faza e parë, në fazën e dytë të studimeve dialektore, shtrohej nevoja e studimit të dialekteve nga vetë shqiptarët, në mënyrë të organizuar dhe me një metodë të njëjtë. Autori shtron si domosdoshmëri zbatimin e në metode të vetme, metodës së klasifikimit strukturor për njohjen e dallimeve morfologjike dialektore të shqipes, si dhe saktësimin e kufijve të shtrirjes së tyre në hapësirë dhe në shtresat e ndryshme shoqërore<sup>1</sup>. Këtë metodë Gjinari e ka zbatuar më herët edhe në studimet e tij për dallimet dialektore në fushën e fonetikës e të fonologjisë<sup>2</sup>. Në artikullin “Sprovë për një klasifikim të dallimeve morfologjike të dialekteve të gjuhës shqipe”<sup>3</sup> autori flet konkretisht për mënyrën e kryerjes së analizës dialektore morfologjike dhe shpjegohet për herë të parë se përse metoda strukturore-funksionale duhet zbatuar edhe në studimin e dallimeve dialektore morfologjike. Gjinari pohon se ndonëse sigurimi i inventarit të dallimeve të folmeve në sistemin morfologjik, krahas atij fonetik, është një kontribut me rëndësi në fushën e studimeve dialektore, sepse nëpërmjet këtij inventari

<sup>1</sup> *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Napoli, 2007, f. 14-15.

<sup>2</sup> J. Gjinari, *Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare*, SF, 1977, 4, f.3-35; *Sistemi fonologjik i zanoreve të dialekteve të gjuhës shqipe*, SF, 1983, 2, f. 50-91.

<sup>3</sup> J. Gjinari, *Sprovë për një klasifikim të dallimeve morfologjike të dialekteve të gjuhës shqipe*, SF, 1984, 3, f. 89-105.

sigurohet një njohje e mirë e ndryshueshmërisë dialektore në sferën e morfologjisë, kjo mënyrë të punuari karakteristike për fazën e parë, është e pamjaftueshme për të pasur një përfytyrim të saktë dhe objektiv për dallimet morfologjike të dialekteve, sepse në fazën e parë dallimet dialektore janë parë si dallime me vlera të barabarta, veçmas nga njëri-tjetri, jo me vlerën dhe shkallëzimin e tyre brenda sistemit. Analiza strukturore në fushën e studimeve dialektore, si metodë, nënkupton që dallimet dialektore të mos trajtohen më si dallime me vlera të barabarta, por në kundërvënien me njëri-tjetrin, për të bërë vlerësimin dhe shkallëzimin e veçorive dalluese morfologjike sipas vendit që zënë dhe sipas funksionit që kryejnë në sistemin gjuhësor të dialektit. Gjinarri pohon se dobia e kësaj metode është se nëpërmjet saj dalin në pah jo vetëm dallimet e tiparet e përbashkëta të të folmeve, pra jo vetëm dallimet e tyre thelbësore, që kanë të bëjnë me sistemin e gjuhës, por edhe dallime jo thelbësore, të cilat janë dallime që nuk prekin sistemin e gjuhës.

Si model teorik për J. Gjinarin në zbatimin e metodës strukturore edhe në studimin e dallimeve morfologjike dialektore ka shërbyer Shkolla e Pragës, përkatësisht Trubeckoi me veprën e tij “Phonologie und Sprachgeographie” (1931), por edhe Heilmann-i me studimin “Per una dialettologia strutturale” (1964). Duke i referuar Trubeckoit, edhe Gjinarri në artikullin e tij pohon se shkalla e dallimeve në sistemin morfologjik mund të evidentohet vetëm nëpërmjet zbatimit të metodës strukturore e funksionale<sup>4</sup>. Po ashtu, duke i referuar veprës së Heilmann-it, pohon se karakteristikë e kësaj metode është përdorimi i materialeve të rrafsheve të ndryshme të gjuhës, si p.sh. funksioni i elementeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre<sup>5</sup>. Duke i parë njësitë morfologjike dialektore si struktura që kundërvihen me njëra-tjetrën nga forma dhe funksioni, Gjinarri e bën klasifikimin strukturor të dallimeve dialektore morfologjike të shqipes sipas katër kriterëve morfologjike:

1. Dallime në inventarin e strukturave.
2. Dallime në variantet e strukturave gramatikore.
3. Dallime në dendurinë e përdorimit të varianteve strukturore.
4. Dallime fonetike të varianteve strukturore.

Këto kritere mundësojnë klasifikimin e këtyre dallimeve në grupe të ndryshme, disa edhe në nëngrupe.

1. *Dallimet në inventarin e strukturave* Gjinarri i sheh në kundërvënien mungesore të kategorive gramatikore në dialekte. Kriteri i përdorur prej tij është ai mungesor ose privativ i kategorive gramatikore dhe i formave gramatikore. Shqipja është një gjuhë me sistem lakimi e zgjedhimi, e pasur

<sup>4</sup> N. S. Trubeckoi, *Phonologie und Sprachgeographie* (1931).

<sup>5</sup> L. Heilmann, *Per una dialettologia strutturale*, in “Communications et rapports du Premier Congrès International de dialectologie générale”; part I, Louvain, 1964, f. 94-97.

me kategori gramatikore, forma e mjete gramatikore, por këto kategori dhe forma gramatikore jo gjithmonë janë pjesë e inventarit strukturor, pra nuk gjenden në të gjitha të folmet ose dialektet. Diku janë të pranishme, diku mungojnë. Diku këto dallime janë të plota, diku janë të pjesshme. Prandaj Gjinari i grupon më tej dallimet mungesore sipas llojit të kundërvënies mungesore, e cila mund të jetë *e plotë ose e pjesshme*. Mbështetur në këtë kriter Gjinari dallon pesë raste dallimesh mungesore të plota të inventarit të kategorive gramatikore te pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, të cilat i përkasin kategorisë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës, të kohëve të foljeve, si dhe formave të temës morfologjike dhe mjeteve të shprehjes së tyre. P.sh. për sa i përket kategorisë gramatikore të gjinisë, dallime vëren te numërori *tre*. Numërori *tre* në gegërishten veriore dhe në toskërishten veriore del me dy forma: *tre* për gjininë mashkullore dhe *tri* për gjininë femërore; në gegërishten veriore edhe numërori *dy* ka dy forma për gjininë: *dy* për mashkulloren dhe *dÿ* (me *y* të gjatë) për femëroren. Në sistemin foljor, në të gjitha të folmet e gegërishtes, shumë rrallë edhe në labërishte, ekzistojnë si kategori e kryera e mbipërbërë (*kam pas shkue, kisha pas shkue*) me të gjitha format e saj vetore, për të treguar se veprimi është kryer shumë kohë më parë se ajo që tregon koha e kryer. Në disa të folme të tjera kjo formë mungon plotësisht. Në fjalëformim, ndryshe nga toskërishtja, në gegërishte ndeshen mbiemrat prejfoljorë me prapashtesën *-shëm* që tregojnë aftësi ose mundësi. Kjo dukuri morfologjike nuk është karakteristike e toskërishtes. Edhe përemrat dëftorë me strukturë të përbërë të tipit *çeky, çekjo, qiky, njaj, çaj, çajo*, etj. janë karakteristike e gegërishtes. Po ashtu, prania e përemrave vetvetorë *i vet, e vet* vetëm në gegërishte, ndryshe nga toskërishtja, e cila kuptimet e këtyre përemrave i mbulon me përemrat pronorë *i tij, e tij* etj. është një tjetër dallim i plotë i përmendur nga Gjinari.

Gjinari vëren se edhe dallimet e pjesshme në inventarin e strukturave morfologjike janë të pakta në numër, pothuajse njësoj sa dallimet e plota. Dallimet hasen në format e një paradigme lakimi ose zgjedhimi. Karakteristikë e tyre është se dalin të gjymtuara, me një formë rasore ose vetore më pak aty ku shfaqen si veçori dialektore. Të tilla janë p.sh. dallimet në disa të folme në sistemin rasor të emrave e të përemrave. Konkretisht te emrat, në të folmet e toskërishtes veriore dhe të gegërishtes jugore, ndeshet forma e rasës vendore me mbaresën *-t*, e shoqëruar gjithmonë me parafjalët *në, nën, nëpër, mbi, me* (në *malt* etj.); te përemrat, haset mungesa e formës së rasës emërore për përemrat vetorë *ne, ju* dhe përdorimi në vend të saj i formës së dhanores *neve, juve*; te përemrat pronorë si shoqërues të emrit vërehet përdorimi i rasave të zhdrejta (*tim, time, tent/tat, tënde/tate*), për gjithë paradigmen e lakimit të këtyre fjalëve, në vend të *im, ime, yt, jote: djali tënd* në vend të *djali yt*. Në zgjedhimin e foljeve ka paradigme të gjymtuar p.sh. në

disa të folme të Përmetit e Kolonjës dhe në disa të folme të Shqipërisë së Mesme nuk ka një formë të veçantë për vetën e parë njëjës të së pakryerës. Në vend të saj është shtrirë forma e vetës së dytë *lanje* (Përmet, Kolonjë) dhe *laje* (në anët e Elbasanit).

2. Në grupin e dytë të dallimeve morfologjike dialektore Gjinari përfshin *dallimet në variantet e strukturave* dhe të *formave gramatikore*. Dallimet në variantet e formave gramatikore nuk kanë të bëjnë me kundërvënien mungesore të kategorive gramatikore, por me kundërvënien të formave si mënyra e mjete të shprehjes së kategorive gramatikore. Dallimet në strukturën e formave me të cilën shprehen kategoritë gramatikore mund të kenë prekur gjithë strukturën e formës ose vetëm morfemat përbërëse. Për pasojë autori dallon tri grupe variantesh të strukturave gramatikore: 1) variante të strukturave të formave dialektore; 2) variante të morfemave ndajshesore dhe 3) dallimet morfonologjike. Dallimet e grupit të parë e të dytë përbëjnë numrin më të madh të dallimeve morfologjike, ndërkohë që dallimet e varianteve të morfemave ndajshesore janë më të shumta se dallimet e varianteve të formave gramatikore.

a) Në grupin e parë të dallimeve sipas varianteve përfshihen dallime që kanë të bëjnë me *variante të strukturave të formave* dialektore. Janë kryesisht dallime variantesh që ndeshen në sistemin foljor e më rrallë në pjesë të tjera të ligjëratës (p.sh. te përemrat pronorë me ose pa nyjë të përparme: *i emi* vs. *imi*; *po shkoj/jam duke shkuar* vs. *jam kah shkoj*; aoristi sigmatik i geg. *lajsha* vs. tosk. *laja*, tek arbëreshët *kam të shkoj* vs. *do të shkoj*; folja ndihmëse *jam* në vend të *kam*: *jam shkue* vs. *kam shkue*; paskajore geg. *me punue* vs. tosk. *për të punuar*. Mbëshetur në kundërvënien e këtyre dukurive Gjinari arrin në përfundimin se këto dallime formojnë izoglosa për ndarjen e dialekteve.

b) Në grupin e dytë të dallimeve sipas varianteve përfshihen dallimet që kanë të bëjnë me *variante morfemash* ndajshesore formëformuese. Zakonisht variantet e mbaresave janë dy, më rrallë ka dhe forma me tri e më shumë variante morfemash. Gjinari vëren se variantet e morfemave mbaresa shfaqen pothuajse vetëm në sistemin foljor, me përjashtim të ndonjë rasti që i përket sistemit emëror. Karakteristikë e këtyre varianteve është se ato nuk formojnë izoglosa për ndarjen e dialekteve të shqipës, por njëri prej tyre ka një shtrirje gjeografike më të madhe në të dy dialektet, sepse paraqitet si variant i përbashkët në të dy dialektet dhe normë e gjuhës letrare. Varianti tjetër ka shtrirje gjeografike të kufizuar, dhe nga pikëpamja e përdorimit mund të jetë ose risi, ose një gjendje më e hershme e gjuhës së përbashkët. Variante morfemash ndajshesore: mbaresa *-i* vs. *-u* pas bashkëtingëlloreve *k*, *g*, *h*: *miki*, *zogi* (geg. verilindore) vs. *miku*; rrjedhorja me mbaresën *-et*: *për doret* vs. *për dore*, *mish lopet* vs. *mish lope*; *themi* vs. *thomi*; *thona* vs. *them*;

pësorja *vritemi, lahemi* vs. *vritna, lahna* (geg. e Shqipërisë së Mesme, pjesa perëndimore); forma sigmatike *u goditësh* ose *u goditsh* (Korça) vs. *u godita*; urdhërore: *uluni* vs. *ulniu, lahuni* vs. *lahniju* (Durrës, Kavajë).

c) Dallimet morfonologjike përbëjnë grupin e tretë të dallimeve sipas varianteve. Këto dallime Gjinari i sheh te temat morfologjike. Autori ka parasysh dallimet në këmbimin e morfemave alomorfe të temave morfologjike, kur këto marrin vlerë morfologjike. P.sh. trajta e shquar e emrave të tipit *ftua, thua, ftue, thue* del me *o* në vend të togut *ua/ue* në shumicën e të folmeve të toskërishtes e të gegërishtes; në geg. veriore tema e këtij emri del e zgjeruar me *n*: *ftoni*. Po ashtu, në disa të folme tema morfologjike e emrave që mbarojnë në *-or, -uall* në disa të folme mbetet e pandryshuar në të dy trajtat (*punëtor-i, buall-i, kërcell-i*); në disa të folme të tjera këta emra dalin me tog zanoresh në trajtën e pashquar (*puntuer/puntur, buall/bull, kërcell*) dhe me zanore të temës të padiftonguar në trajtën e shquar (*puntori, bolli*).

3. Grupi i tretë i përcaktimit të dallimeve morfologjike përfshin dallimet sipas shpërndarjes ose distribucionit të varianteve gramatikore morfologjike brenda një të folmeje. Ato kanë të bëjnë me dendurinë e përdorimit të varianteve brenda të një të folmeje. Dallimet në këto raste nuk kanë të bëjnë me inventarin e strukturave ose me variantet dialektore të formave gramatikore, pra nuk janë dallime morfologjike të mirëfillta. Ato janë thjesht sasiore, jo mungesore. Nga këto variante, njëri ka fituar më shumë përdorim në dëm të një varianti tjetër, është shtuar p.sh. numri i njësive të klasave leksikore ose dhe gramatikore në grupin e një kategorie (gjinia etj.) ose në grupin e një klase fjalësh që kanë si karakteristikë një mbaresë të caktuar (shumësi, shquarsie, foljeje etj.). Këto lloj dallimesh të shpërndarjes janë të kushtëzuara semantikisht ose gramatikisht dhe dalin në klasa të caktuara fjalësh. Kushtëzimi semantik ka ndikuar në dallimet e gjinisë së emrave: emrat e lëndës, si *dyllë, djathë, brumë, mjaltë, ujë, grurë* etj. diku janë asnjans, diku i shtohen klasës së emrave mashkullorë. Emrat si *nder, qytet, lot, kryq, shëndet*, diku janë mashkullorë, diku i shtohen grupit të emrave femërorë (geg. veriperëndimore).

4. Grupi i katërt i dallimeve morfologjike përfshin dallimet fonetike të formave gramatikore. Variantet gramatikore të këtij grupi kanë të bëjnë me anën tingullore. Gjinari sqaron se ashtu si dallimet sipas distribucionit, edhe këto dallime nuk janë dallime strukturore të mirëfillta, sepse, ndryshe nga dallimet sipas inventarit ose sipas varianteve, të cilat kanë prekur strukturën e kategorive gramatikore dhe të formave gramatikore, dallimet fonetike të këtij grupi nuk e kanë prekur strukturën e kategorive gramatikore dhe të formave gramatikore. Të tilla janë p.sh. fjalët *lumenj-lumej, thonj-thoj, unë* vs. *u; ai-ay; ky, kjo-qy, qo; punoj-punonj, do të laj-do laj*. Siç shihet, dallimet fonetike

në këto raste lidhen vetëm me strukturat gramatikore, jo me ato tingullore, sepse nuk janë të kushtëzuara fonetikiisht në njërin apo tjetrin dialekt.

Me mjaft interes janë përfundimet e Gjinarit nga kjo sprovë e klasifikimit morfologjik të dallimeve dialektore. Në përfundimet e nxjerra nga studimi dhe nga përlllogaritja me shifra konkrete Gjinari pohon se dallimet më të rëndësishme morfologjike janë ato që lidhen me inventarin e strukturave dhe me variantet e strukturave të formave. Së dyti, këto dallime të këtyre dy grupeve janë të një numri më të vogël se dallimet e tjera (rreth 28.5% të të gjitha dallimeve të tjera). Dallimet jo të mirëfillta kanë një numër më të madh: 41,5 % të të gjitha dallimeve të tjera. Po ashtu me rëndësi janë edhe përfundimet lidhur me ndikimin dhe bashkëveprimin reciprok të gjuhës standarde me dialektet e shqipes. Nga studimi del se përgjithësisht gjuha letrare ka marrë nga dialektet ato dukuri morfologjike që janë të domosdoshme për sistemin e saj dhe që janë me shtrirje gjeografike më të gjerë. Konkretisht, gjuha letrare shqipe ka marrë nga dialektet ato tipare të inventarit të strukturave sipas kriterit mungesor, që janë më të domosdoshme e me shtrirje gjeografike më të gjerë. P.sh. ka lënë jashtë format e përemrave *qeky, qekjo*, funksionet e të cilave, ashtu si dhe shumica e të folmeve e dialekteve, i mbulon me mjete sintaksore, si p.sh. pjesëza *ja: ja ky, ja kjo*. Po ashtu ajo ka marrë nga të folmet e dialektet rastet e ruajtjes së plotë të paradigmeve rasore. Edhe te dallimet sipas varianteve gjuha letrare ka marrë nga dialektet format që janë të përbashkëta e që kanë përhapje më të madhe. Këto përfundime janë të rëndësishme, sepse provojnë se, me gjithë dallimet morfologjike ndërmjet dy dialekteve të shqipes, dukuritë morfologjike të përbashkëta në të dy dialektet janë më të shumta se ato që i ndajnë.

Si përfundim, sprova e J. Gjinarit për klasifikimin morfologjik të dallimeve dialektore shënon një hap të mëtejshëm përpara në fushën e studimeve dialektore të shqipes, sepse përveç dallimeve fonetike, për herë të parë metoda strukturore përdoret edhe në fushën e studimeve të morfologjisë dialektore. Gjithashtu, artikulli i Gjinarit shpreh edhe nevojën e përsosjes së mëtejshme të metodologjisë së punës së punës kërkimore-shkencore jo vetëm për dallimet morfologjike. Në artikull theksohet me të drejtë nevoja për një hetim të plotë të sintaksës dialektore dhe ndërmarrjen e studimeve sistematike e të thelluara të dallimeve strukturore edhe në fushën e sintaksës dialektore, sepse ato nuk pasqyrohen mjaftueshëm në ADGjSh, vetëm me nëntë harta, nga të cilat vetëm disa prej tyre i përkasin sintaksës dialektore.

Sprova e klasifikimit morfologjik të dallimeve dialektore u kurorëzua me pasqyrimin e këtyre klasifikimeve strukturore në *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe*, vepër madhore e gjuhësisë shqiptare. “Atlasi” përmban 70 harta për të gjitha strukturat morfologjike dialektore, shoqëruar edhe me

pyetësorin përkatës, gjë që mundëson ndërmarrjen e studimeve të mëtejshme për një përshkrim të plotë të sistemit morfologjik.

## SUMMARY

### **JORGJI GJINARI ON THE METHODOLOGY OF STUDDING DIALECTAL DIFFERENCES IN MORPHOLOGY**

The outhor of this article focusese on the contribution of linguist Jorgji Gjinari in the fied of albanian dialectology. Gjinari as a linguist, among else, has payed attention to the improvement of scientific level of albanian linguistic studies. As a wellknown dialectologist, he thinks that applying a scientific methodology in Albanian dialect studies, is the only way for reaching scientific results. Based on the wellknown "The linguistic circle of Prague", in 1984 he proposed a methodology and analysis which was different from that of the first stage of Albanian dialects studies. Gjinari claims that in the first phase of dialectological studies, up to the early 50s of XX century, studies were committed mainly by foreigners, they were disorganized and did not cover entierly all the characteristics of Albanian dialects speaches. Gjinari emphasised that, unlike the first phase, during the second phase of dialect studies, it was necessary the study of Albanian dialects in an organized manner and with the same scientific method. He finds very apropiate the implementation of structural-functional classification method for the recognition of albanian morphological differences in dialects of Albanian, as well as for specifying limits of their expansion in space and in different social strata. Gjinari has implemented this method earlier in his studies, for bringing in the spot of light differences in the field of phonetics and phonology of Albanian dialects. In his article "Essay for a classification of morphological diversity of dialects of Albanian language" author speaks specifically about the way of performing morphological analysis and dialect. For the first time he explained why the structural-functional approach should be applied even in the study of morphological dialectal differences. Gjinari asserts that while ensuring inventory of differences in dialectal system of morphology, along with that of phonetic one, is an important contribution in the field of albanian dialectology, because through this inventory it is possible to have a good knowledge of the variability of dialects in the field of morphology, this way of working, characteristic for the first stage, is insufficient for having an accurate vision and objective morphological differences of dialects, because in the first phase of dialect studies, differences are seen separately from each other, with the same value and without their escalation within the system.

According to Gjinari, applying structural-functional analysis in the field of dialectal studies, as a method, means that the dialectical differences, even in morphology, should not be treated anymore as differences with equal values, but in opposition to each-other. In this way the researcher can evaluate and represent the escalation of distinguished morphological features depending on the place they belong and by the function they perform in dialect language system. Gjinari claims that the usefulness of this method is that through it emerge not only the differences and the common features of the speech, not only their core or essential differences, dealing with the system of language, but also nonessential differences, which are differences that don't affect language system.

